



Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

LAJMËRIM PARAPRAK

për publikim të Thirrjes publike numër 01/2025 për parashtrim të kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Instrumenti për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi 2021-2027)

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural i lajmërojnë të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se në kuartalin e katërt të vitit 2025 do të shpallet Thirrje publike për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga Instrumenti për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD Programi për periudhën 2021-2027).

Qëllimi i IPARD Programit 2021-2027 është përmes masave përkatëse për mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural të përmirësohet konkurrenca e prodhimit bujqësor dhe sektorit bujqësor-ushqimor, përmes harmonizimit të tyre me standardet e Bashkimit Evropian dhe arritjes së ambientit të qëndrueshëm jetësor dhe zhvillim socio-ekonomik në mjediset rurale përmes nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe rritjes së mundësive për punësim.

Mjetet financiare nga IPARD Programi 2021-2027 në lidhje me realizimin e kësaj Thirrje publike nga viti 2025 dedikohen për Masën 1: Investime në mjete fillestare të ekonomive bujqësore për sektorët në vijim:

1. Sektori i prodhimit bimor dhe nën sektorët vijues:
 - kulturat e drithërave,
 - kulturat industriale dhe foragjere,
 - vreshtat (vetëm varietetet për verë),
 - kultura të tjera nga Aneksi I që nuk mbështeten në kuadër të Masës 7.
2. Sektori i prodhimit blegtoral dhe nën sektorët vijues:
 - gjedhe (për: blegëtori qumështi, majmëri),
 - derra (për: mbarështim, majmëri),
 - dele dhe dhi (për: kultivim dhensh e dhish për qumësht, majmëri),
 - pulari (pula për vezë, zogjë që rriten për mish – broilerë),
 - bagëti të tjera nga Aneksi I që nuk mbështeten në kuadër të Masës 7
3. Sektori i peshkatarisë: ferma akuakulture për peshqit e ujërave të ëmbla.
4. Përpunimi dhe marketingu i drejtpërdrejtë i prodhimit bujqësor të vetë fermës dhe nën sektorët e mëposhtëm:
 - qumështi dhe produktet e qumështit
 - vezët, mishi dhe produktet e mishit
 - frutat dhe perimet, duke përfshirë patatet dhe kulturat bishtajore;
 - mushti, lëngu i rrushit, vera.
5. Prodhimi i energjisë nga burime të rinovueshme për nevojat e tyre

Thirrja publike e ardhshme e IPARD Programit 2021-2027 ofron mundësi të shtuara për sa i përket llojit të investimeve, një volum më të madh përdoruesish potencialë ose në përgjithësi mbështeten investimet në prodhimin primar të ekonomive bujqësore me qëllim përmirësimin e performancës së përgjithshme, produktivitetit ekonomik dhe konkurrenca ekonomike bujqësore.

Rregullat për shfrytëzimin e mjeteve financiare nga IPARD Programi 2021-2027 udhëzojnë lidhjen paraprake të kontratës së shfrytëzuesve potencial me Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe realizimin e investimit të lejuar në pajtim me kushtet e kontraktuara paraprakisht. Kontrollim në vend të ngjarjes dhe zbatimin e mbikëqyrjes së kontratës e kryejnë personat e autorizuar nga Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural dhe institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë së Veriut për udhëheqje, zbatim dhe kontroll të IPARD dhe Bashkimit Evropian.

Mënyra dhe procedura për shfrytëzimin e mbështetjes financiare nga IPARD Programi 2021-2027 janë të shënuara në Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga Instrumenti për ndihmë parahyrese për zhvillim rural të Bashkimit Evropian.

Shpallja do të zgjasë së paku **45 ditë** nga dita e shpalljes së Thirrjes publike në gazetatat ditore.

VËREJTJE: Dokumentacioni i duhur për përgatitje dhe dorëzim të kërkesave, duke përfshirë dhe Udhëzimet për shfrytëzuesit në lidhje me Masën 1 “Investimet në mjete fillestare të ekonomive bujqësore ” nga IPARD Programi 2021-2027 do të azhurnohen dhe publikohen në ueb faqen e Agjencisë në periudhën deri në shpalljen e Thirrjes publike 01/2025.

Informacione më të hollësishme në lidhje me llojet e investimeve, kriteret për fitimin e mbështetjes financiare dhe shuma e mbështetjes, të interesuarit mund t'i marrin në Agjencinë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.





Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural

Telefoni: 02 3097-460
Faksi: 02 3097-454
e-mail adresa: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk
www.pa.gov.mk

Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomizimit të ujërave Sektori për udhëheqje me IPARD
Telefoni: 02 3134-477 lok: 113, 114 dhe 115
e-mail adresa: info@ipard.gov.mk
www.ipard.gov.mk

Agjencia për nxitje të zhvillimit në bujqësi
Telefoni: 047 228-330
Faksi: 047 228-370
www.agencija.gov.mk çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Prodhuesit bujqësorë të interesuar mund të marrin informacion për përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesave, si dhe këshilla praktike për aplikim, pa pagesë në qendrat rajonale të Agjencisë për nxitjen e zhvillimit në bujqësi. (Në faqet e internetit të institucioneve kompetente publikohet lista kontaktuese e qendrave rajonale dhe personave kompetentë).

